

AUTOCHTONY OF ALBANIANS ACCORDING TO GERMAN STUDIES

AUTOKTONIA E SHQIPTARËVE SIPAS STUDIMEVE GJERMANE

Melihate ZEQIRI¹

1 Faculty of Language, Cultures and Communication, South East European University - Tetovo*

**Corresponding author email: melihatez@gmail.com*

Abstrakt

Ne kemi veçuar kontributin që kanë dhënë studiuesit gjerman për autoktonin shqiptare dhe studimeve krahasimtare, që arritën t'i bëjnë. Kemi veçuar filozofin më të madh të kohës së tij G. V. Lajbnic, i mbiashtuquajtur "Aristoteli i kohëve moderne". Kemi veçuar kritikun dhe filozofin gjerman të shekullit XVIII, Johan Gotfrid von Herder, i cili në veprën "Ide për filozofinë e historisë së njerëzimit" shpreh idenë për autoktoninë shqiptare.

Kemi përmbledhur edhe historianin Johan Erih Tunman me prejardhje suedeze, por ka qenë pedagog i oratorisë dhe i filozofisë në Universitetin gjerman të Halles. Thunman është historiani i parë, i huaj që është marrë seriozisht me studimin e prejardhjes së shqiptarëve në veprën "Kërkime rreth historisë së popujve të Evropës Lindore" 1774. Mirëpo, mbetet nga studiuesit e kohës së sotme të thellojnë studimet gjuhësore për të zhvilluar etimologjinë shqipe.

Fjalët kyçe: autoktoni, gjuhë, kombë, krahasim, lashtësi.

Sfondi historik

Meqenëse studiuesit gjerman i vënë theks të veçantë lashtësisë së popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe, gjatë studimit kemi hasur në studiues të disiplinave të ndryshme shkencore, si: gjuhësi, histori, filozofi etj. Pra, përkthyesi Nelson Çabej ka sjellë në gjuhën shqipe studimet nga origjinali në gjuhën frengë, librin "Autoktonia shqiptare në studimet gjermane", por, njohësi i gjuhësisë shqiptare më i shquari deri me sot, siç është Eqrem Çabej është marrë hollësisht me studimet për lashtësinë e shqipes dhe vendin e shqipes në mesin e gjuhësisë indoevropiane, në vëllimet: "Studime gjuhësore III, V, VII", "Hyrje në historinë e gjuhës shqipe".

Edhe studiues të tjerë janë marrë me studimet për lashtësinë e shqipes, por ne kemi hasur në studimin e Shefki Sejdiut, "(Ilirio-Arbroro) shqiptarët dhe gjuha e tyre në universin global". Në kohën e fundit, studime për shqipen dhe shqiptarët ka bërë edhe albanologu i shquar gjerman Robert Elsie, po ashtu edhe akademik Mark Krasniqi.

<https://doi.org/10.62792/ut.filologjia.v12.i22-23.p2518>

“Historia e një gjuhe është njëkohësisht historia e një populli”- Fr. Kluge¹

Historia e gjuhës është historia e popujve që i flasin e i kanë folur. Popujt e kombet gjatë jetës që bëjnë si popuj, si kombe kanë fatet e tyre historike e politike. Ata gjatë historisë së tyre zhvillojnë mënyrën e jetesës e të mendimit. Ndryshojnë marrëdhëniet ekonomike e shoqërore, idetë politike, institucionet fetare etj. Gjithashtu me kohë u zhvillohet mënyra e jetesës, mënyra se si banojnë, si kanë e si vishen, edhe mënyra e trajtat e të menduarit. Të përshkruash zhvillimin e gjithë këtyre trajtave të jetës së një populli, do të thotë të shkruash historinë e tij. Po një nga këto trajta është edhe gjuha. Një popull, siç ndron në rrymë të kohëve gjithë format e jetës së tij, Ashtu bashkë me to zhvillon e ndron edhe gjuhën që flet².

Historinë e një gjuhe mund ta nisim që nga koha që ajo gjuhë është shkruar. Vetëm kur është shkruar, një gjuhë ka marrë fizionominë e saj të veçantë, ka zënë një vend të caktuar në historinë e kulturës së njerëzimit. Në këtë kuptim mund të themi se historia e indishtes fillon me Vedet, historia e greqishtes me mbishkrimet përpara Homerit, historia e bullgarishtes me përkthimet e Cirilit e të Metodit, dhe historia e shkurtër e gotishtes mund të themi se nis edhe mbaron me biblën e peshkopit Wulfila. Edhe historia e armenishtes fillon me përkthimet e Ungjillit nga shek. V pas erës sonë. Pa shkrime, pra nuk kemi histori të një gjuhe.

Në punë të dokumentimit me shkrim, gjuhët në pikëpamje të kohës ndahen nga njëra-tjera. Sikundër dihet, disa nga to janë shkruar shekuj përpara erës sonë, disa edhe mija vjet më parë. Të tjerat, përkundrazi, kanë zënë të shkruhen pas erës sonë, disa vetëm në prak të kohës së re. Një nga më të fundit nga kjo anë është gjuha shqipe. Historia e shqipes mund të themi se fillon me kohën qëkur e gjejmë të shkruar për të parën herë, me shek. XV, edhe më mirë në vitin 1555, viti që na ka dhënë *Mesharin* e Gjon Buzukut, e para vepër që ne njohim në gjuhën tonë.

Po t'i hedhim një vështrim historisë së gjuhës shqipe, dy gjëra të kundërta na bien në sy në këtë lëmë: më një anë një gjuhë e dëshmuar me shkrim mjaft vonë, më anë tjetër një popull i lashtë, autokton në këto vise të Ballkanit që në kohët e mugëta të prehistorisë. Historikisht Shqiptarët bashkë me Grekët janë populli më i vjetër i Gadishullit. Ky popull në këto rreth 3000 vjet që po rron në këto anë, ka pasur sigurisht historinë e tij; ka folur gjithashtu brez pas brezi gjuhën e tij, të cilën, me ndrimët që ka pësuar me kohë, e flasin sot stërnipët e atyre të parëve.

Sikundër shohim ne kemi përpara një gjuhë e cila si gjuhë e folur është kaq e lashtë, po si gjuhë e shkruar është kaq e re, sepse e dokumentuar kaq vonë. Ky është një kontrast nga i cili ka për të vuar patjetër çdo histori e kësaj gjuhe. Perioda pesëqindvjeçare e shqipes së shkruar nuk është veçse një pjesë e vogël nga historia e gjuhës, faza më e re e zhvillimit të saj historik. Shqipja është për fat një gjuhë e gjallë³.

Gjurmë lashtësie

Për shkak të mungesës së të dhënave për Shqipërinë dhe shqiptarët gjatë një periudhe të mesjetës (shek. VI deri IX), prejardhja e shqiptarëve u bë objekt i një debate të gjatë shkencor. Për këtë arsye, në studimet gjermane për historinë e Shqipërisë prejardhja e popullit shqiptar ka zënë një vend qendror. Studimi i gjuhës shqipe për të arritur në përfundime mbi prejardhjen e saj e të shqiptarëve si folës të saj, filloi qysh me G. V. Lajbnicin dhe J. Thunmanin në dy skajet kohore të shekullit XVIII, dmth. në një periudhën kur ende nuk kishte lindur gjuhësia

¹ Dr. H. Barić, Hymje në historinë e gjuhës shqipe, Shtëpia Botuese “Mustafa Bakija” Prishtinë, 1955, f. 4. <https://www.biblioteka-ks.org/>

² Çabej, Eqrem; *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë e Filologjisë, 1988, f. 9, Tiranë.

³Po aty, 11

krahasuese që formuloi parimet në bazë të të cilave mund të krahasohej struktura gramatikore, sistemi fonetik dhe leksiku i gjuhëve të së njëjtës familje⁴.

Studimi i parë gjerman, e njëkohësisht evropian, rreth prejardhjes së gjuhës e të shqiptarëve i takon filozofit më të madh të kohës së tij, Gotfrid Vilhelm Lajbnicit. Siç tregon ai vetë, këtë përpjekje ia kishte kërkuar bibliotekari i Bibliotekës Mbretërore në Berlin, ku tanimë, me iniciativën e vetë Lajbnicit, ishte themeluar Akademia e Shkencave të Prusisë. Por, duhet mbajtur parasysh se studimi i gjuhëve për Lajbnicin nuk ishte thjeshtë një hobi. Në qëllimin e tij të madh për të krijuar një histori universale të botës, gjuhët e njerëzimit ishin elemente themelore për të kuptuarit e asaj historie dhe për shpjegimin e saj.

Ai mendonte se studimi i gjuhëve nga një pikëpamje krahasimtare do të mund të shpinte drejt një gjuhe paraardhëse të gjuhëve të sotme dhe do të ndriçonte shumë anë të prehistorisë së njerëzimit. “Këto gjuhë, thoshte ai, rrjedhin nga një burim i përbashkët”. Nga kjo pikëpamje Lajbnici duket se i parapriu në objektin gjuhësisë krahasimtare që do të lindte në atdheun e tij, në Gjermani, me një plejadë të tërë gjuhëtarësh, si: Franc Bop, August Shlahjer etj., që vazhdon edhe sot të mbetet në themelin e studimeve historiko-gjuhësore. Koha tregoi se, ashtu siç synonte dhe shpresonte Lajbnici, në shumë raste, fjalët e gjuhës mbeten monumentet me te vjetër e mjaft të sigurt për njohjen e shumë aspekteve të prehistorisë (të historisë) së popujve.

Pikërisht, nga fjalët ai përpiqet të nxjerrë një përfundim rreth natyrës dhe prejardhjes së gjuhës shqipe në tri letra që tanimë njihen si “Letra shqiptare”, e që Lajbnici ia dërgonte bibliotekarit të Bibliotekës Mbretërore të Berlinit. Nga letra e parë ne mësojmë se një opinon sado i turbullt rreth prejardhjes ilire të gjuhës shqipe ekzistonte edhe më parë dhe ai njihet nga Lajbnici. Por autori i letrës, pa asnjë paragjykim, shpreh një mendim të kundërt me atë, duke e konsideruar si një gjuhë sllave, ndërsa ndonjë mbeturinë e gjuhës ilire, sipas tij, mund të gjendet në malet e Epirit.

Pesë vjet më vonë, në letrën e dytë të datës 10 dhjetor 1709, ai ndërron mendimin dhe e quan shqipen “*gjuha e ilirëve të lashtë*”. Ai thotë se kishte shtënë në dorë një libër dhe një fjalor të gjuhës shqipe, të cilët ne e dimë se janë “Doktrina e kërshenë” (1618) e Pjetër Budit dhe “Fjalori latinisht-shqip” (1635) i Frang Bardhit. Së pari, pasi u njoh me këtë material gjuhësor të shqipes, ai e përjashtoi atë nga grupi i gjuhëve sllave, gjë që nuk ishte vështirë për një njohës të madh të gjuhëve evropiane siç është Lajbnici. Së dyti, etimologjizimet që u bënë tetë fjalëve shqipe e shpien atë në përfundimin se shqipja, ndonëse një gjuhë e veçantë, ka lidhje gjenetike me gjuhët gjermanike, latine, sllave, kelte, greke, skithe, dmth. me gjuhë që, siç dimë sot, bëjnë pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane.

Kështu në një mënyrë më shumë intuitive sesa shkencore, Lajbnici, ishte i pari që arriti deri në një “teori ilire” të gjuhës shqipe e të popullit shqiptar. Në vitin 1774 në Lajpcig u botua “*Untersuchungen uber die Geschichte der ostlichen europaischen Volker*” (Kërkime për historinë e popujve të Evropës Lindore), i Johan Thunmanit, një libër që i kushtohet historisë dhe prejardhjes së shqiptarëve dhe rumunëve, e cila, siç shprehet ai, është “e palëruar, e djerrë, e shkretë”, sepse “parapëlqeva të hap këtu një udhë të re, në vend që të bëja diçka aty ku udha ka qenë e hapur”⁵.

Kështu e karakterizon ai në vitet 70-të të shekullit XVIII, shekullit të iluminizmit, shkallën e mosnjohjes së Shqipërisë e të shqiptarëve në Evropën Perëndimore. Dhe me të vërtetë Thunmani me këtë vepër del si eksploratori i parë i Evropës shkencore në historinë e shqiptarëve. Nga pikëpamja metodologjike Thunmani e ka kapërcyer përfundimisht metodën narrative që kishte sunduar gjatë tërë periudhës së Rilindjes evropiane dhe tërë të metat që e karakterizonin atë. Njohja e thellë e burimeve të lashtësisë në këtë vepër u përplotësua me të dhënat gjuhësore.

⁴Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane, përktheu Nelson R. Çabej, redaktor: Fahredin Gunga, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 13

⁵J. Thunman, *Untersuchungen uber die Geschichte der ostlichen europaischen Volker*, Leipzig, 1774. (Parathënie)

Tetëdhjetë vjet para Hanit ai do arrinte në të njëjtin përfundim me të, dmth. se maqedonët, epirotët dhe ilirët flisnin të njëjtën gjuhë. Thunmani, gjithashtu, është i pari që është sprehur hapur e qartë se huazimet sllave të shqipes lidhen kryesisht me pushtimet bullgare e serbe të trojeve shqiptare gjatë mesjetës. Ai duke ndjekur zhvillimet historike mijëvjeçare në këto troje arrin në përfundimin e mirënjohur se “Në historinë e shqiptarëve, unë nuk kam gjetur ndonjë gjurmë mërgimi të mëvonshëm e gjuha e tyre ka dhënë dëshmi të atilla për fatet e popullit, sa që unë e kam të pamundur të mos njoh në ta fqinjët e lashtë të grekëve dhe qytetarët e Romës së lashtë. Por të dyja këto më tregojnë ilirët”⁶.

Filozofi dhe teoricieni i historisë së shekullit XVIII Johan Gotfrid Herder, në veprën e tij të mirënjohur “Ideen zur Geschichte der Menschheit” (“Ide për historinë e njerëzimit”) – 1784 – 1791, duke parashtruar idetë e tij mbi thelbin e historisë e të qytetërimit njerëzor, bën fjalë dhe për popujt e sotëm të Evropës e të botës. Jozef Riter fon Ksilanderi ka qenë i pari që ka përmendur në veprën e tij “Gjuha e albanezëve ose shqiptarëve” (Die Sprache der Albanesen oder Schkipëtare, 1835) një pasazh nga vepra e filozofit të madh, të cilin e përdor si një citat autoritar për ta vënë në një faqe të veçantë në fillim të librit të tij: “Ata nuk janë aspak të huaj, por një popull i lashtë i familjes evropiane”⁷.

Ndonëse embrionale, ideja e J. G. Herderit se shqiptarët nuk janë aspak të huaj, por një popull i lashtë i familjes evropiane ishte e vlefshme për t’u përfshirë në këtë përmbledhje jo vetëm sepse i përket një filozofi, dijetari dhe teoricieni të historisë me përmasa botërore, por, para së gjithash, sepse bashkëpohon, duke përdorur një koncept të tij, me “ndjenjë”(Gefühl), autoktoninë e popullit shqiptar. Pasi flet për popujt e ardhur në epokën historike si gotët e sllavët e më vonë hazarët, peçenegët, avarët, hunët, bullgarët e hungarezët, ai bën fjalë për popujt e vegjël evropiane që janë pasardhës të banorëve të stërlashtë prehistorike të Evropës.

Shihet qartë se për Herderin, për atë Herder që në idenë e kombësisë sheh një nga forcat lëvizëse kryesore të historisë së çdo populli; a. shqiptarët janë një popull me histori të lashtë, b. shqiptarët rrjedhin prej ilirëve. Ne nuk dimë nëse kur shkruante për shqiptarët, Herderi ishte njohur me letrat shqiptare të Lajbnicit, me punimin e J. Thunmanit “Kërkime në historinë e popujve evropianë lindorë” dhe me zbulimin e Uilliam Xhonsit që tregonte për ekzistencën e një familjeje gjuhësh me prejardhje të përbashkët që, më vonë, do të njihej si familja e gjuhëve indoevropiane, dmth. ne nuk dimë nëse këtë pikëpamje e ka marrë nga autorët e mësipërme apo ajo është një përfundim i arritur prej tij në mënyrë të pavarur.

Këtu duhet të mbahet parasysh edhe fakti se në kohën kur është botuar vepra në fjalë e Herderit, për Evropën shkencore ishte bërë e njohur edhe pikëpamje që mohonte autoktoninë e shqiptarëve (prejardhjen ilire të tyre) nëpërmjet autorëve bizantinë Halkokondili dhe historianëve kishtarë *Le – Quien* dhe *Assemani*, që i bënin shqiptarët të ardhur gjatë mesjetës, i pari nga Alba e Italisë, kurse dy të tjerët nga Albania e Kaukazit. Kështu Herderi, me sa dimë, është autori i tretë gjerman (njëkohësisht evropian) që shprehet në favor të prejardhjes ilire të shqiptarëve⁸.

Gotfrid Vilhelm Lajbnic (1946 - 1716)

Filozofi më i madh i kohës së tij, i mbiquajtur “Aristoteli i kohëve moderne”. Albanologu Eric Hamp si ne shqiptarët e vlerëson Lajbnicin, si “një dijetar të hershëm të vërtetë të gjuhësisë shqipe” (vep. e cit. f.41/ Hamp, 1981: 34-36), udhëhapësin e studimeve në fushën e gjuhës sonë, që ndonëse punoi një shekull para lindjes së gjuhësisë krahasimtare, me një intuitë të jashtëzakonshme, arriti i pari në një teori “ilire” të prejardhjes së gjuhës shqipe.

⁶ Vep. e cit. Çabej, 1990: 19/ Thunman, 1774, f. 245

⁷ Po aty, 19

⁸ N. Çabej, 1990: 13-21

Kontributi i Lajbnicit në fushën e gjuhësisë përfshihet në tri letra, që ai i ka dërguar bibliotekarit mbretëror të Berlinit, tanimë të njohura në botën shkencore si “letra shqiptare të Lajbnicit” (Leibnizen’s Albanerbriefe⁹)¹⁰. Në letrën e parë të datës 24 janar, të vitit 1705, ai shprehte mendimin se shqipja duhej të ishte një gjuhë sllave, kurse gjuha e ilirëve të lashtë mund të ekzistonte diku në Epir. “Përsa i përketë gjuhës së shqiptarëve, unë dyshoj se ajo mund të jetë një gjuhë sllave, meqë kjo gjuhë zotëron gjatë brigjeve të detit Adriatik. Gabimisht atë e quajnë gjuhë ilirike (*Lingua illirica*). Por unë besoj se gjuha e ilirëve të lashtë ishte një gjuhë krejt e ndryshme. Në qoftë se do të kishte ndonjë mbeturinë të saj në malet e Epirit, kjo do të ishte shumë kurioze dhe e denjë për kërkimet tona”¹¹.

Letrën e dytë ai e shkroi thuajse pesë vjet më vonë, më 10 dhjetor 1709 (Hanover), pasi kishte shtënë në dorë një libër dhe një fjalor të gjuhës shqipe që është identifikuar nga Eric Hamp, përkatësisht me Fjalorin latinisht-shqip të Frang Bardhit (*Dictionarium latino-epiroticum, Romae, 1635*) dhe veprën e Pjetër Budit. “Kur Z. Hubener, që vinte nga Holanda, kaloi këtu, unë iu luta të më merrte një dorëshkrim të Bibliotekës Mbretërore, që po jua kthej duke ju falënderuar dhe dëshiroj të më jepni nderin t’ju shruaj në të njëjtën kohë. Ju më keni dhënë një kënaqësi të madhe duke më njoftuar se keni marrë një libër dhe një fjalor të gjuhës shqipe; nga kjo mësoj se kjo ishte gjuha e ilirëve të lashtë. Unë vë re në të edhe shumë fjalë latine. Atijonë për babai jonë; me gjermanishten si: *deet (tokë), enendieni (na falni)*”¹².

Duke hedhur poshtë mendimin e shprehur në letrën e parë se “gjuha e ilirëve të lashtë ishte një gjuhë krejt e ndryshme nga shqipja” kurse në letrën e dytë, ai arriti në përfundim “...kjo ishte gjuha e ilirëve të lashtë”. Në letrën e tretë, 26 dhjetor 1709, Lajbnici ben krahasimin e disa fjalëve të shqipes me gjuhët indeoevropiane, si: “*Hundë* – qeni quhet *Hund* nga gjermanët; *Hunting* është gjuetia tek anglezët; *hint* për ata do të thotë gjurmë, shenjë, që gjermanët e sotëm e quajnë *Spuhr*. Mundet që të gjitha të vijnë nga një rrënjë që tregon *Kunde*, njohuri e nga e cila mund të ketë ardhur edhe njoh... Unë nxjerr një përfundim të ngjashëm edhe për *kraha* të shqipës, sepse *Krebs* ose *Crabbe* është një kafshë me krahë dhe *Krallen*, kthetra, *Krazzen*, *kraun*, *Kriechen*, *zvarrite*... mua më duket se *Massa* është mishi për sllavët, kështu që kjo lidhet me mish (mix) të shqipes, e Mis të armenishtes...”¹³

Johan Gotfrid von Herder (1744-1803)

Kritik dhe filozof gjerman i shekullit XVIII. Herderi pati një krijimtari shumë të madhe e të gjithanshme, me të cilën ndikoi në zhvillimin e letërsisë, të shkencave shoqërore e të vetëdijes kombëtare të gjermanëve. Për ne paraqet rëndësi të veçantë vepra e tij e pambaruar “*Ideen zur Philosophie der Geschichte der Menschheit*” (Ide për filozofinë e historisë së njerëzimit) e shkruar në vitet 1784-1791, nga e cila kemi nxjerrë një fragment, ku shprehet ideja e Herderit për autoktoninë e shqiptarëve. Herderi nuk sjell ndonjë argument për këtë, pohimi i tij ka rëndësia historike që nuk mund të nënçmohet, po të mbajmë parasysh kohën kur u shpreh dhe personalitetin e tij si teoricien e filozof i historisë.

Ide për historinë e njerëzimit – Leipzig, 1868, vëll. III, f. 99.

“...Ende më pak të drejtë kemi të fusim ata popuj që kanë dalë nga ilirët, trakët dhe maqedonasit e lashtë dmth. shqiptarët, vllahët, arnautët. Ata nuk janë aspak të huaj, por një

⁹ Origjinalet e letrave janë frëngjisht.

¹⁰ Vep. e cit. f. 41/ Reiter, 1980: 82-93

¹¹ N. Çabej, 1990: 43

¹² Po aty, 41-43

¹³ Po aty, 44-45

popull i lashtë i familjes evropiane; dikur ata kanë qenë kombe kryesore, kurse sot kanë mbetur si gërmadha të braktisura të shumë popujve dhe gjuhëve...”¹⁴

Johan Erih Thunman (1746-1778)

Thunman historian me prejardhje suedeze, ka qenë pedagog i oratorisë dhe i filozofisë në Universitetin gjerman të Halles. Ai është i pari historian i huaj që është marrë seriozisht e posaçërisht me studimin e prejardhjes së shqiptarëve në veprën “Untersuchungen uber die Geschichte der oadichen europaischen Volker” (Kërkime rreth historisë së popujve të Evropës Lindore) të botuar në Lajpcig, në vitin 1774. Sipas Thunmanit, shqiptarët ishin popull i panjohur në atë kohë në Evropën Perëndimore. Thunmani ishte produkt i përfaqësuesëve të “shekullit të iluminizmit”.

Për të arritur në një përfundim të mbështetur shkencërisht rreth prejardhjes dhe gjuhës së shqiptarëve ai bën një shqyrtim kritik të hollësishëm të të dhënave të autorëve të lashtë grekë e romakë, si dhe të burimeve mesjetare ekzistuese, nga ana tjetër, të gjuhës shqipe dhe të lidhjeve të saj të fqinjësisë me greqishten, latinishten dhe sllavishten e jugut. Siç dihet, ky shqyrtim objektiv i të dhënave që kishte në dispozicion e shpuri Thunmanin në përfundimin se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve, një përfundim që i ka qëndruar kohës, që sot përfaqëson një të vërtetë historike. Siç është shprehur prof. A. Buda “vepra e Thunmanit përbën një ndihmesë për ta vënë mbi baza shkencore problemin e formimit të popullit shqiptar e të gjuhës shqipe”.

***Kërkime në historinë e popujve të Evropës Lindore* – Leipzig, 1774**

Thunman në parathënien e librit shprehet: “Shkenca e historisë, ashtu si thuajse të gjitha shkencat në këtë shekull të iluminizmit, ka hedhur hapa të mëdhenj drejt përsosmërisë... Por në Evropën Lindore pamja e saj është krejtësisht e ndryshme. Asnjë popull tjetër i pjesës së botës në të cilën jetojmë nuk është aq i panjohur për ne evropianët e Perëndimit, përsa i përket prejardhjes, historisë dhe gjuhës, sa shqiptarët e vllahët. Ata janë popuj kryesorë, popuj të lashtë e të rëndësishëm, që çdo historian do të dëshironte t’i njihje: historia e tyre do të plotësonte zbrazëti të mëdha në historinë e lashtë e të re të Evropës.

Në fillim do të bëj të njohur një fjalor shqip e një trako-vllahisht. Mbase kjo do të jetë dhe pjesa më interesante e punimit tim. Një fjalor latinisht-shqip e ka botuar në Romë, në vitin 1635 Frang Bardhi, kurse Pjetër Budi ka bërë një përkthim shqip të Katekizmit të Belarminit, që është botuar në shtypshkronjën e kongregacionit të propagandës në vitin 1664. Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve të lashtë, po ashtu si fqinjët vllahë të tyre, janë bij të trakëve. Populli i parë që njeh historia në këtë vend janë ilirët, një popull i madh, i shumë në numër dhe i fuqishëm, që, sipas Strabonit dhe Apianit, banonte në detin Adriatik, nga lumi Po deri në Gjirin e Ambrakisë e në veri deri në Danub.

Prejardhja e shqipes - shqiptarëve

Në çështjen me të cilën po merremi këtu, dihet se janë përfaqësuar dy drejtime kërkimi. Sipas njërit drejtim gjuha shqipe e ka vendin në truallin e saj të sotëm që prej kohës së vjetër. Sipas tjetrit, bartësit e saj, në atë epokë ose më vonë, kanë shtegtuar e kanë zënë vend në vendbanimet e sotme duke ardhur prej një treve më në lindje, përkatësisht më në veri. Për brezat e mëparshëm të dijetarëve, të cilët kanë marrë mjaft parasysh rrethanat historike, shqiptarët janë autoktonë. Sipas studiuesit Shefki Sejdiu “Fiset e periudhës kohore 6000-2600 Ceka i quan preilire (Ceka 29). Këto fise preilire, preitalike, prekelte, aty kishin jetuar në fqinjësi një kohë të gjatë dhe në bazë të të dhënave kronologjike ata kishin qenë *dolicocefalë* (Pittard, 32; Milaj, 74).

¹⁴Po aty, 48-49

Këto fise edhe nga ajo hapësirë kishin lëvizur: *prekeltët* drejt Perëndimit, *preitalikët* drejt Apenineve e *preilirët* drejt Dravës, Savës, Danubit, Adriatikut e përgjatë gadishullit, që më vonë do të quhej nga romakët *Paeninsula illyrica* apo *Illyricum*. Këtë emër do ta mbajë gadishulli deri në fillim, të shekullit XIX, kur zëvendësohet nga emri *Ballkan* me origjinë turko-orientale. Emrin Ballkan për herë të parë e ka përdorur gjeografi gjerman A. Zeune në vitin 1909 (LJLZ, 76)¹⁵”

Gjurmë interferimesh - Dyndja e fiseve indoevropiane nga hapësira e hershme në drejtim të Europës dhe Mediterranit dhe transformimi onomastik i *pre-ilirëve* në *proto-ilirë*, në ilirë dhe në *arbëroro-shqiptarë*. Megjithatë, duhet thënë diçka edhe për origjinën e disa formave që i konsiderojmë me interes për të kuptuar më mirë relevancën e këtyre toposeve etnonimike e bivalente popujsh e hapësirash që shtrihen në kohë deri në parahistori e që grosso modo prekin tri periudha kohore, që arkeologu N. Ceka do t'i quante preilire, prehelene, preitalike (6000-2600 para epokës së re), përkatësisht *protoilire*, *protohelene*, *protoitalike*.

Periudha që Ceka e shënon me proto-, sipas tij përfshin 2600-1200 vjet para epokës së re (shih Ceka, 29v, 31v). Mendojmë, pra, që etnonimi *ilir* duhet t'i kishte takuar mileniumit të parë para epokës së re, por shumë kohë përpara se të jenë përmendur nga Herodoti, edhe fiset që nga Histria deri të Kaoni janë fise *ilire* e jo *protoilire* dhe emërtimet e tyre, me gjasë janë formësuar në hapësirat e gadishullit që më pastaj, do të quhet *Ilirik*. Sipas Thunmanit “Ilirët dhe trakët ishin prej kohësh popuj kryesorë të Evropës. Në lashtësi shiheshin si popuj me zakone të njëjta.... Vendi që sot quhet Shqipëri ka qenë i banuar nga fise të ndryshme që bënë pjesë që të gjithë në popullin ilir.... Pasardhësit e banorëve të stërlashtë të kësaj pjesë të Ilirisë do të përmenden me emrin *albanë*, ose *arbanë*.”¹⁶

Sot Shqiptarët e njohin vendin e tyre me emrin *Shqipëri*, Shqipni, popullin me emrin *Shqiptar*, gjuhën me *shqip*. Po në kohë të mesme dhe për një kohë mjaft të gjatë të kohës së re vendi quhej *Arbër*, *Arbën* dhe populli *Arbëreshë*, *Arbëneshë*. Emri *Arbër*, *Arbën* është sigurisht vazhdimi mesjetar i emrit të *Albanoive*, atij fisi në Shqipëri të mesme që shënon gjeografi aleksandrin Ptolemeu në shek. II, pas Kr. midis Orestis dhe Almopernit, në lindje të Leshit, me kryeqytetin *Albanopolis*. Ky emër për shumë kohë nuk ndihet më në histori. Pas nëntë shekujve nga koha e Ptolemeut kronisti bizantin Mihail Ataliates i përmend Shqiptarët më 1072 me emrin *Arvanites*; më 1079 princesha bizantine Anna Komnena, e bija e perandorit Aleks Komnenit, me rastin e luftrave të t'et me Normanë në Shqipëri, flet për këtë vend që e quan *Arvanon*; kurse Georg Akropolita e quan më vonë *Alvanon*.

Në kohë të mesme Kruja quhet te Latinët *Arbanum*, peshkopi i Krujës episcopus *Arbanensis*. Anjoutë i quanin vendet që zotëronin në Shqipëri të mesme regnum *Albaniae* (1370). Nga lat. *Albanenses* rrodhi ital.. *Albanese*. Greq. *Arvanitis* është vazhdimi i emrit bizantin të Shqiptarëve; prej greqishtes e muarën emrin turqit, të cilët me metatezë e bënë *Arnaut*. Serbët na kanë quajtur gjithë kohën dhe na quajnë *Arbanasi*, Aromunët *Arbinesi*. Të gjithë këta emra vërtetojnë se emri *Shqiptar*, *Shqipëri* në kohë të mesme nuk kishte dalë ende si emër kombëtare i popullit e i vendit. Siç pamë nga shembujt më lart, për popullin në atë kohë përdorej sipas krahinave *Arbëresh*, *Arbënesh*, për vendin *Arbër*, *Arbën*¹⁷.

Për *Arbër* është vështirë puna e origjinës nga trajta vetë e emrit, sepse këto janë dy: në Shqipëri me *Arb-* (*Arbër*) po në të huaj edhe me *Alb-* (*Albania*). Pedersen anon nga mendimi që *Arb-* është trajta e vjetër e emrit dhe kjo mund të jetë e drejtë, po më anë tjetër edhe *Alb-* është e moçme, sepse e gjejmë që te Ptolemeu. Sa për origjinën e emrit, dijetari grekoshqiptar P. Furikis mendon se vjen nga një *arbë*, kjo prej kelt. *alb alp* “naltësi e rëpjetë”, ku hyn dhe emri i Alpeve; pas mendimit të tij fjala kelte në shqipet hyri me anë të ilirishtes. Sirdani përkundrazi nisat nga kuptimi “rrafshinë”, po kjo nuk është e sigurtë.

¹⁵ Sejdiu, Shefki; (Ilirio-Arbroro) shqiptarët dhe gjuha e tyre në universin globalist, ERA, Prishtinë, 2016, f. 92-97

¹⁶ Po aty, 52-60

¹⁷ Çabej, 1988: 187-188

Por, sipas Shefki Sejdiut thuhet “Vlen të theksohet se kjo bazë *alb-*, nuk përmban elemente semike as mitologjike, as legjendare, por është e mbështetur në faktorë gjeofizikë, në shkëmbinjtë, lartësinë, borën e bashësinë e Alpeve Albane.”¹⁸ *Albano – shqiptarët*, edhe kjo periudhë etnohistorike e etnosit *iliro-albano-shqiptar*, kohësisht nuk është e përcaktuar. Ka shumëgjasa të kenë filluar me paraqitjen e fiseve terciare siç i quan Shufflay (Shufflay, 60), kur bëhej një përpjekje e tretë për rikonsolidimin etnik në kulmin e sundimit ottoman. Sidomos pas luftërave të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut dhe disa rrethanave që krijohen në Europë (ri)ngjallet ndjenja që në tërë hapësirën arbërore ku jetonin njerëz të një gjaku e gjuhe të definoheshin gjuhësisht, territorialisht dhe etnikisht.

Në *Kuvendin e Arbërit* (1703) doli një formë e re adverbial *me fol shqip* në vend të asaj që do të ishte më e pritshme me fol arbërisht (shih Ismajli, 224). Për përdorimin e kësaj forme të re janë ende të paqarta impulse e (ri)motivimin për ta krijuar këtë formë të re. Por, meqë del nga një tubim aq me rëndësia, siç ishte ai i Kuvendit të Arbërit, rrënjët do të duhej kërkuar te një fazë dhe bazë më e hershme, siç do të ishin paraqitja dhe shtrirja e ideve reformatore si dhe nevoja që predikimet (fetare) të bëhen në gjuhën që e kupton populli dhe ndoshta, edhe verbi *excipio, excipere* “*kuptoj, me kuptue*” nga rodhi edhe fjala shqip “*kuptueshëm*”, siç e kishte interpretuar edhe Gustav Meyeri¹⁹.

Kjo formë ndjafoljore *shqip* (<lat. *excipio* “*kuptoj*”) mund të ketë shërbyer si nukleus për krijimin e paradigmes *shqip* (flas) – (gjuhë) *shqipe* – (popull) – *shqiptar* – (vendi) *Shqip(ë)ni, Shqipëri*. Mirëpo, ky interpretim nuk duhet marrë aq thjeshtë. Pët t’u ndërtuar një paradigmë aq e bukur, aq ekspresive, e qartë, e pranueshme dhe gjithëpërfshirëse, rrënjët duhet kërkuar më thellë: në traditë e histori, në rrethana që sillnin epoka reformatore dhe e Renesancës që kishin filluar në Itali me Danten, me idetë kalviniste në Zvicër dhe ato luteriane në Gjermani e më gjerë, me ato paskaliane e më vonë edhe iluministe në Francë.

Në traditën gojore shqiptare përcilleshin, mbahe(shi)n mend e (ri)kujtohe(shi)n figurat e njohura të periudhave të ndryshme të historisë *iliro-albano-shqiptare*. Kujtesë e bukur e motivuese ishte për arbërorët thënia se Pirroja për ushtarët e vet ishte *shqiponjë*, kurse për Pirron ushtarët ishin *krihët e saj*. Këto dalin si reminishenca edhe tek Skënderbeu kur vëren entuziazmin dhe gëzimin e popullit për lirinë që po ua sillte. Ai u përgjigjet se *lirinë nuk ua kishte sjellë, po e kishte gjetur midis tyre*. (Franke, 332)

Të tilla (ri)kujtime, ndoshta, e (ri)sjellin *shkabën, shqiponjën* në sistem të kujtesës së popullit se shqiponja si koncept dhe totem me shekuj kishte qëndruar në vertikalen gjarpër – shqipe (shqiponjë) – diell (qiell) paradigme mitike e përbashkët për shumë popuj të Mesdheut e më gjerë. Në këtë sistem të menduari, shqiponja funksionalizohet edhe si stimulues, edhe si motiv(im), edhe si bazë konceptualizimi e kodifikimi për të marrë pjesë në krijimin përmes kryqëzimeve asociative, të një ekuacioni: *excipio + shqip(e) +shkabë (+shqiponjë)* për të arritur deri te paradigma me pak ndryshime: *shqip(e)-shqip(e)tar-Shqip(e)ni-Shqipëri* apo edhe më qartë: (flas) *shqip-(gjuhë) shqipe – (popull) shqiptar – (vendi) Shqipëri*.²⁰

Emrin *shqip, Shqiptar* G. Meyeri²¹ e lidh me foljen *shqiptoj* dhe këtë e nxjerr nga lat. *excipio* “*ndiej, dëgjoj*”, kështu që *Shqiptar* vjen të thotë “ai që kupton” (si Sloven që lidhet me slovo “*fjalë*” dhe do të thotë “ai që flet e kupton”). Përkundrazi M. Lambertzi emrin e bie të ardhur nga Shqipja, shqiponja, si emër të një totemi (Parimet e linguistikës 54 v.) prej kohës së Skënderbeut. Mendimi i këtij dijetari austriak ka të gjarë të jetë i drejtë, dhe është i pranuar prej shumëve. Me të vërtetë shqiponja gëzon një nderim ndër Shqiptarë dhe konsiderohet si shpendi kombëtarë i tyre: emrin e saj *shqipe* e gjejmë te Buzuku (LXXXII/2), te Bardhi 59 si dhe te Shqiptarët e Greqisë.

¹⁸ Sejdiu, 2016: 104

¹⁹ Fjalori Etimologji, Meyer, f. 480

²⁰ Sejdiu, 2016: 104-106

²¹ Fjalori Etimologji, Meyer, f. 411.

Le të shënojmë së fundi se dijetari grek A. Ch. Chatzis emrin *Shqiptar* e nxjerr (1929) nga greq. e re *skipetton* “pushkë”, fjalë që vjen prej ital. *schioppetto* dhe njihet në Greqi nga shek. XVI-XVII. Kështu që shqiptar do të thotë “pushkatar”²². Sado që këto afrime duken të justifikueshme, mbetet t’i konsiderojmë vetëm një sprovë rreth një çështjeje gjuhësore që do hulumtime të mëtejme për zgjidhje të arsyeshme etimologjike. Më, 23 gusht 2011, Beogradin e vizitoi kancerlarja gjermane **Angela Merkel**. Me këtë rast, ajo ia bëri me dije kryetarit të Serbisë, Boris Tadiqit se pavarësia e Kosovës, sovraniteti dhe tërësia e tokave të saj janë çështje e mbyllur. **“Kombi shqiptar në Ballkan dhe kudo në botë, popullin gjerman e ka në zemër!”**²³

Përfundime

Duke vlerësuar lart punën e madhe të studiuesëve gjerman për autoktonin e shqiptarëve, studimet shkencore që sollën studiuesit gjatë viteve të tëra dhe gjurmimin që bën për krahasimin e fjalëve me gjuhët e përafërta apo gjatë studimeve të tyre, ata hasën dilema për shqipen, se a është pasardhëse e ilirishtes, apo del nga gjuha sllave apo trake, por gjermanët i kushtuan vëmendje të madhe dhe punuan në studimet e tyre me përkushtim të jashtëzakonshëm, derisa erdhën në përfundim me argumente të shumta, duke dëshmuar lashtësinë e shqipes dhe shqiptarëve me dokumente dhe me vendbanime të paraardhësve të shqiptarëve, ilirëve. Pra, gjetën fjalë të përafërta dhe bën krahasimin me gjuhët indoevropiane, ku dëshmuar lashtësinë e përdorimit të fjalëve dhe autoktonin shqiptare.

Gjatë studimit është parë kontributi i shquar i studiuesëve gjerman për shqipen dhe shqiptarët. Gjatë hulumtimeve të tyre, lindi edhe gjuhësia krahasimtare, në periudhën kur kishte paqartësi për lashtësinë e shqipes, por, fal punës së madhe dhe interesimit të studiuesëve gjerman, edhe sot e kësaj dite është bërë e qartë autoktonia e shqiptarëve. Duke parë rëndësinë e studimeve gjermanë që janë bërë për shekuj të tërë, ne rekomandojmë që studiuesit shqiptarët të gjuhësisë krahasimtare të gjurmojnë edhe më shumë studiuesit e studimeve gjermane dhe të përkthejnë edhe më shumë studime nga gjermanishtja në gjuhën shqipe.

Pra, studiuesit shqiptarët t’i kushtojnë rëndësia të madhe përkthimeve nga gjuhësia krahasimtare, dhe të dëshmojnë ende më shumë autoktonin shqiptare, duke iu dhënë vlerësime të larta studiuesëve të ndryshëm, që u moren me shqipen dhe shqiptarët, sepse atyre iu takojnë meritat më të larta. Tani, është koha që Akademitë, Universitetet, Institutet përkatëse të organizojnë seminare shkencore për kontributin e studiuesëve gjerman nëpër shekuj që kanë dhënë për gjuhën shqipe dhe shqiptarët deri me sot, sepse fal studimeve të veçuara të tyre, ne gëzojmë sot vlera të autoktonisë dhe arriti të zhvillohet etimologjia e shqipes.

Referencat

- [1]. *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*, përktheu Nelson R. Çabej, redaktor: Fahredin Gunga, Rilindja, Prishtinë, 1990.
- [2]. Sejdiu, Shefki; (*Iliro-Arbroro*) *shqiptarët dhe gjuha e tyre në universin globalist*, ERA, Prishtinë, 2016.
- [3]. Çabej, Eqrem; *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, FHF, 1988, Tiranë.
- [4]. Çabej, Eqrem; *Studime gjuhësore III*, Rilindja, Prishtinë, 1976.
- [5]. Çabej, Eqrem; *Studime gjuhësore V*, Rilindja, Prishtinë, 1976.
- [6]. Çabej, Eqrem; *Studime gjuhësore VII*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- [7]. Demiraj, Shaban; *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Rilindja, Prishtinë, 1988.
- [8]. Demiraj, Shaban; *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* (1986), Rilindja, ribotuar në Prishtinë (1988).
- [9]. H. Baric; *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, SHB “Mustafa Bakija”, Prishtinë, 1955.
- [10]. E. P. Hamp, *On Leibniz’s Third Albanian Letter*, *Zeitschrift für Balkanologie*, Jg XVII/1, 1981, f. 34-36
- [11]. Erik P. Hamp; *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK, 37, Prishtinë, 2007.
- [12]. J. Thunman, *Untersuchungen uber die Geschichte der ostlichen europaischen Volker*, Leipzig, 1774.

²² Çabej, 1998: 193

²³ Posted on 26/ 8/ 2011 by shkupipress <https://shkupipress.wordpress.com/>